



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

Projekti i USAID-it Drejtësi për të gjithë

KËRKESË PËR APLIKIME (RFA-JAG-2017-005)

Ngritja e Shërbimit për Verifikim Faktesh në Shqipëri

I. PËRSHKRIMI I PROJEKTIT

Projekti “Drejtësi për të Gjithë” i USAID-it (në tekstin e mëposhtëm “Projekti”) është një projekt pesë vjeçar (2016-2021) i hartuar për të përmirësuar performancën e gjykatave përmes zbatimit të standardeve gjithëpërfshirëse të performancës gjyqësore lidhur me efikasitetin, transparencën, aksesueshmërinë dhe llogaridhënien. Projekti i ofron ndihmë edhe organizatave të shoqërisë civile, mediave dhe gazetarisë investigative për të forcuar rolin e tyre si aktorë të rëndësishëm në procesin e reformës në drejtësi dhe si mbikëqyrës të zbatimit të reformave. Qëllimi përfundimtar i projektit është të rrisë besimin e publikut në sistemin gjyqësor shqiptar.

II. PËRSHKRIMI I MUNDËSIVE PËR FINANCIM

Në dekadat e fundit, shërbimet profesionale për verifikimin e fakteve janë shfaqur si një mjet shumë i rëndësishëm për vlerësimin e saktësisë së deklaratave të bëra nga zyrtarët publikë, partitë politike, kandidatët, gazetarët, organizatat e lajmeve, shoqata dhe grupe të tjera. Duke shfaqur të vërtetën dhe jo të vërtetën, shërbimi për verifikim faktesh: (i) bën që zyrtarët publik, kandidatët, partitë, stafi, dhe përkrahësit e tyre të jenë më të kujdesshëm në lidhje me atë çfarë thonë; (ii) jep informacion shpjegues të pavarur, që politikanët dhe gazetarët mund ta përdorin si një kornizë apo pikë referimi për të diskutuar çështje komplekse; dhe (iii) vepron si avokat në emër të qytetarit dhe jo nga një burim partizan i informacionit.

Projekti synon të akordojë një grant për një organizatë Shqiptare të shoqërisë civile (OShC) që ka interesin dhe kapacitetin për të hartuar Shërbimin për Verifikim të Fakteve. Aplikantët duhet të kenë aftësinë për të verifikuar deklaratat e politikanëve dhe jo vetëm nëpërmjet kërkimeve në arkiva, në baza të dhënash (database), dhe burime të tjera të informacionit, si për shembull: televizioni, regjistrimet/pamjet, gazetën, radio, etj.

Projekti kërkon që aplikanti i zgjedhur të jetë i angazhuar me organizata monitoruese të shoqërisë civile që kanë interes dhe kapacitet për të kontrolluar faktet që lidhen me qeverisjen e mirë, kundër korrupsionit, si dhe çështjet e transparencës, si dhe të angazhojë gazetarë, studentë dhe ekspertë, të cilët do të kryejnë vëzhgimet kryesore dhe vlerësimet lidhur me saktësinë dhe vërtetësinë e informacionit të publikuar dhe transmetuar bazuar në burimet e disponueshme.

Projekti kërkon propozime kreative dhe inovative për të hartuar një Shërbim për Verifikim të Fakteve të besueshëm dhe me cilësi të lartë në Shqipëri, në përputhje me praktikën më të mirë ndërkombëtare dhe standardeve në këtë fushë.

Propozimet për hartimin e Shërbimit për Verifikim të Fakteve në Shqipëri duhet të planifikojnë hapa konkretë për të arritur objektivat e mëposhtme:

1. Të monitorojë dhe raportojë për saktësinë faktike të deklaratave të aktorëve më të mëdhenj politikë, opinionistëve dhe gazetarëve në formën e deklaratave dhe konferencave për shtyp, reklamave televizive, debateve, fjalimeve, intervistave, etj.
2. Të ndihmojë gazetarët për të raportuar saktë duke zbatuar praktikën më të mirë në kohë të gazetarisë të bazuar në fakte;
3. Të sigurojë akses për gazetarët dhe qytetarët për rezultatet e kontrollit të fakteve nëpërmjet mediave tradicionale dhe mediave sociale, si dhe një bazë të dhënash;
4. Të kontribuojë për të rritur besueshmërinë e raporteve të medias duke identifikuar lajmet e rreme;
5. Të rrisë njohurinë publike, të kuptuarit, dhe kërkesat për informacion të bazuar në fakte;
6. Të kontribuojë për të rritur aftësinë e qytetarëve për të përdorur të menduarin kritik dhe verifikues mbi informacionin që ata marrin përmes mediave.

Projekti do të ndihmojë fituesin e grantit të zhvillojë metodologjinë për të zhvilluar Shërbimin për Verifikim të Fakteve dhe për të pasur mjete efikase të monitorimit për të siguruar cilësi të lartë të shërbimit. Pamvarësisht se mund të duhet një kohë më e gjatë për ta bërë Shërbimin për Verifikim të Fakteve plotësisht operacional, aplikantët duhet të planifikojnë që të kryejnë disa verifikime faktesh gjatë fushatës elektorale në zgjedhjet e përgjithshme të 18 qershorit, 2017 dhe të shpërndajnë gjithnjë e më shumë shërbime gjatë gjithë kohëzgjatjes së projektit.

Projekti do të ndihmojë fituesin e grantit për të publikuar dhe për të vënë në dispozicion rezultatet e Shërbimit për Verifikim të Fakteve përmes stacioneve televizive dhe radiofonike, faqeve të internetit, dhe platformave përkatëse të mediave sociale, si Facebook dhe Twitter.

Propozimet duhet të trajtojnë në mënyrë të veçantë të gjitha objektivat e renditura më sipër. Përveç kësaj, në mënyrë që të merren parasysh, të gjitha propozimet duhet të përfshijnë elementet e kërkuara në shtojcën A: Formularin e Aplikimit për Grant dhe duhet të propozojnë strategji për zbatimin e suksesshëm të aktiviteteve të kërkuara nga granti, duke përfshirë futjen e risive, të cilat janë të përshtatshme për pikat e forta të organizatës të tyre.

Projekti nuk do të shqyrtojë aplikimet që përfshijnë aktivitetet e mëposhtme:

- Mbështetje për apo lobim në emër të një partie politike;
- Aktivitete fetare;
- Aktivitete humanitare;
- Hulumtime teorike;

III. AKORDIMI I GRANTEVE

Projekti planifikon të akordojë një grant që varion nga \$ 65,000 deri në \$ 85,000 për aktivitete që mbulojnë një periudhë prej 12 (dymbëdhjetë) deri në 18 (tetëmbëdhjetë) muaj. Fondet e grantit mund të përdoren vetëm për aktivitetet që lidhen drejtpërdrejt me ngritjen e Shërbimit për Verifikim të Fakteve në Shqipëri.

Projekti rezervon të drejtën për të akorduar një grant ose asnjë në përgjigje të çdo aplikimi të pranuar. Aplikantët duhet të ndërmarrin të gjitha kostot dhe rreziqet që lidhen me përgatitjen e propozimeve të paraqitura në përputhje të kësaj KPA-je. Më tej, Projekti rezervon të drejtën për të pranuar ose refuzuar ndonjë ose të gjitha aplikimet e dërguara, dhe ka të drejtë të kërkojë sqarime shtesë nga aplikantët.

IV. AFATET KOHORE

Të gjitha propozimet duhet të përfshijnë një afat kohor të udhëhequr nga afatet e mëposhtme:

Hapja e Ftesës për Propozime:	10 mars 2017
Afati për Kërkesa për Sqarime:	20 mars 2017
Përgjigjet për Kërkesat për Sqarime:	22 mars 2017
Afati Përfundimtar i Dorëzimit:	10 prill 2017, në 17:00
Shqyrtimi i Propozimeve:	11–24 prill, 2017
Lajmërimi i Vendimit Përfundimtar për Akordimin:	28 prill 2017

Ju lutemi vini re se datat e vlerësimit dhe akordimit mund të ndryshojnë.

V. KRITERET E PRANUESHMËRISË

Projekti kërkon aplikime nga OShC të afta për të ngritur një Shërbim për Verifikim të Fakteve, mundësisht me një histori të provuar në aktivitetet monitoruese duke u përqëndruar në një qeverisje të mirë dhe kundër korrupsionit.

Për më tepër, aplikantët duhet të përmbushin edhe kriteret e mëposhtme:

- Aplikantët duhet të kenë kapacitetet e duhura institucionale dhe ekspertizën për të verifikuar imtësisht, në kohën e duhur, deklaratat e politikanëve, zyrtarëve publikë, gazetarëve dhe opinion bërësve përmes hulumtimeve në arkiva, bazat e të dhënave, si dhe burime të tjera në dispozicion të informacionit, siç janë pamjet televizive, gazetatat apo radio.
- Të kenë të paktën një vit përvojë operationale. Si rregull, Projekti nuk do të ofrojë fonde për ngritjen e organizatave të reja, megjithatë Projekti mund të bëjë përjashtime të rralla nëse paraqiten prova të mjaftueshme që tregojnë se drejtuesit e organizatës kanë përvojë të mëparshme në këtë fushë.
- Të kenë një sistem transparent kontabiliteti që është në përputhje me legjislacionin shqiptar dhe Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (IAS). Nëse nuk ka një sistem të tillë, grant marrësi duhet të punojë ngushtë me zyrën e Projektit, për të siguruar krijimin e sistemeve të sakta të menaxhimit financiar dhe kontabilitetit transparent.

- Nuk duhet të jetë debitor, dhe duhet të ketë shlyer të gjitha borxhet ndaj shtetit, ose të ketë arritur në marrëveshje për pagesën e plotë të borxhit përpara përfitimt të kështit të parë të fondeve nga granti i Projektit.
- Duhet të veprojë si një organizatë e pavarur dhe pa lidhje politike.
- Nuk duhet të jetë i ndaluar, pezulluar, përjashtuar, ose i papranueshëm në forma të tjera nga përfitimi i fondeve Federale të SHBA-së.
- Nënpunësit civilë, të emëruarit politikë, anëtarët e Kuvendit aktual, personeli i shoqërive publike të transmetimit dhe/ose drejtues të partive politike nuk mund të marrin pjesë në një projekt financiar me grante si drejtor apo si një pjesëmarrës i shpërblyer me fonde nga granti.

Aplikantët e zgjedhur për përfitimt e granteve do t'i nënshtrohen një vlerësimi rreziku përpara akordimit të ndërmarrë nga Projekti për të përcaktuar nëse aplikanti ka kapacitetet minimale menaxhuese për të punuar me fonde të Qeverisë së SHBA-së. Për këtë arsye, përpara marrjes së vendimit përfundimtar, Projekti mund të kërkojë dokumentacion shtesë, që përfshin por nuk kufizohet në sa më poshtë:

- Kopje të dokumentit më aktual të regjistrimit të organizatës;
- Raport audituesi;
- Deklarata financiare (pasqyrë financiare, fitimet dhe humbjet, xhiro); dhe
- Politikat e organizatës.

Projekti nuk do të akordojë një grant për një organizatë që nuk ka një numër të DUNS për projekte me vlerë \$25,000 e më lart. Prandaj, aplikantit të suksesshëm do t'i kërkohej të marrë një numër DUNS. Projekti do t'i ofrojë udhëzime aplikantit fitues për procedurën që do të ndjekë për të marrë një numër DUNS.

Shënim: Partneritetet mes 2 (dy) ose më shumë OSHC-ve janë të inkurajuara. Secili prej anëtarëve në një partneritet të tillë duhet të përmbushë kriteret minimale të pranueshmërisë të përcaktuara më lart. Megjithatë, dokumentacioni shtesë për vlerësimin e rrezikut përpara akordimit kërkohej vetëm për organizatën e autorizuar/kryesuese të partneritetit të OSHC-ve. Për më tepër, OSHC-të individuale që përbëjnë partneritetin duhet të dorëzojnë gjithashtu një letër bashkëpunimi, ose një Memorandum Mirëkuptimi (MM).

VI. PROCESI DHE KRITERET E VLERËSIMIT

Procesi i përzgjedhjes do të administrohet nga Komisioni i Vlerësimit të Granteve (GRC) i ngritur nga Projekti. Nëse një aplikim futet në listën e shkurtër për financim të mundshëm, aplikantit përkatës mund t'i kërkohej të japë informacione të mëtejshme. Projekti do të vlerësojë propozimet bazuar në kriteret e mëposhtme të vlerësimit të meritës:

Kategoria e Vlerësimit	Klasifikimi Pikët
Zbatueshmëria e Projektimit dhe Qasja Teknike <i>(përfshin 10 pikë që vlerësohen veçmas për Qasjen Bashkëpunuese, që do të merret në konsideratë vetëm kur aplikimi dorëzohet nga një partneritet me OSHC të lejuara të aplikojnë)</i>	50

Kapacitetet Teknike dhe Menaxhuese	30
Performanca e Shkuar	15
Efikasiteti i Kostos	5
Gjithsej	100

Këto elemente të kriterëve të vlerësimit të meritës përshkruhen plotësisht më poshtë.

1. Qasja Teknike

a. Zbatueshmëria e Projektimit dhe Qasja Teknike

- Shkalla në të cilën aplikimi i përgjigjet KPA-së për aplikime dhe sa trajton qëllimet e Projektit dhe objektivat e përgjithshme për ngritjen e një Shërbimi për Verifikim të Fakteve;
- Te tregohet se kuptohen problemet/çështjet që synon të trajtojë Kërkesa për Aplikime;
- Potenciali i projektit për të arritur me sukses dhe efikasitet objektivat e përcaktuar në Pikën II më lart;
- Masa në të cilën projekti sjell qasje novatore dhe mundësisht të përsëritshme;

b. Qasja Bashkëpunuese (vetëm nëse aplikanti është në një partneritet OSHC-ësh të lejuara të aplikojnë)

- Shkalla e bashkëpunimit midis OSHC-ve shqiptare në ndarjen e ekspertizës dhe burimeve për zbatimin e qasjeve në funksion të përmbushjes së qëllimeve të projektit është e përcaktuar qartë dhe shpjeguar përmes rolit, pjesëmarrjes dhe kontributeve të përcaktuara për secilën OSHC.

2. Aftësitë Organizative, Teknike dhe Menaxhuese si dhe Performanca e Shkuar

a. Kapaciteti Teknik dhe Menaxhues

- Kapaciteti teknik dhe menaxhues i aplikantit (aplikantëve) për të zbatuar me sukses projektin. Kjo përfshin një vlerësim të:
- Nivelit të burimeve (njerëzore dhe financiare) të mjaftueshme për arritjen e objektivave të përgjithshëm të projektit;
- Historikut të punës dhe angazhimit të treguar të aplikantit për të zbatuar veprimtaritë e propozuara dhe aftësinë e treguar për të punuar mirë me organizata të tjera dhe partnerë të tjerë;
- Përvojës dhe ekspertizës së ekipit menaxhues dhe personelit të propozuar për projektin;
- Ofrimit të mekanizmave dhe stafit të përshtatshëm për monitorimin, vlerësimin dhe raportimin në lidhje me projektin.

b. Performanca e Shkuar

- Performanca e shkuar në arritjen e rezultateve pozitive gjatë zbatimit të veprimtarive të ngjashme me ato të propozuara;
- Përvojë pune me fondet e USAID/donatorëve të tjerë dhe aftësia për të përmbushur kërkesat për raportim dhe llogaridhënie;
- Aftësia e treguar për të mbledhur dhe analizuar të dhëna në lidhje me rezultatet e projekteve.

c. Kapaciteti Organizativ

- Fuqia e përgjithshme financiare e aplikantit;

- Struktura organizative dhe praktikat e qeverisjes së mirë të aplikantit.

3. Efikasiteti i Kostos

- Buxheti duhet të jetë (i) i plotë dhe tërësisht i dokumentuar, (ii) i arsyeshëm, dhe (iii) i shpërndarë sipas zërave të përshtatshëm buxhetorë;
- Buxheti duhet të tregojë një lidhje të qartë dhe të drejtpërdrejtë midis veprimtarive të propozuara dhe përdorimit të propozuar të fondeve;
- Shpenzimet e propozuara duhet të jenë të lejueshme dhe të alokueshme në projekt.

VII. RREGULLORET PËR AUTORITETIN/QEVERISJES

Akordimet e dhëna organizatave që nuk janë nga SHBA-ja duhet ti përmbahen udhëzimeve të përcaktuara në Kapitullin 303 të ADS “Grantet dhe Marrëveshjet Bashkëpunuese me Organizatat Jo Qeveritare” dhe mbulohen nga termat e Dispozitave Standarde të USAID për Marrësit Jo Qeveritarë, që nuk janë nga SHBA-ja, si dhe procedurat e përcaktuara në manualin ‘Grantet me Kontratë’ të Projektit Drejtësi për të Gjithë i USAID. Për më tepër ADS 303 i referohet dokumenteve të tjera rregullatore të nxjerra nga Zyra për Menaxhimin e Buxhetit (OMB) e Qeverisë së SHBA-së dhe nga Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar:

- 2 CFR 200 Kërkesat Administrative Uniforme, Parimet e Kostos dhe Kërkesat e Auditit për Akordimet Federale, Nën-Pjesa E; dhe
- 2 CFR 700 – zbatimi nga USAID i 2 CFR 200.

Projektit i kërkohet të sigurojë që të gjitha organizatat që marrin fonde grantesh nga USAID, të jenë në përputhje me udhëzimet e përcaktuara në rregulloret e referuara më lart, sipas zbatimit të termave dhe kushteve përkatëse të akordimeve të granteve të tyre.

VIII. PROCEDURAT E DORËZIMIT TË APLIKIMEVE

Projekti do të pranojë aplikime në anglisht. Formatit që do të përdoret për hartimin e aplikimit është përcaktuar në Shtojcat A-E. Aplikantët do të dorëzojnë aplikimin e tyre teknik dhe buxhetin në formatet e dhëna dhe ndjekin drejtimet dhe udhëzimet e renditura në këto shtojca.

Paketa e Aplikimit: Për të shkarkuar paketën e aplikimit, ju lutemi të lexoni lajmërimin e Ftesës për Aplikim në adresën www.ewmi.org. Gjithashtu mund të kontaktoni Projektin në adresën grants_icpp@ewmi.org për të marrë një formular aplikimi. Kur të bëni kërkesën tuaj, ju lutemi referojuni “RFA-JAG-2017-005”.

Sqarime: Aplikantët duhet të dorëzojnë kërkesat për sqarime brenda afatit të përcaktuar në Pikën IV më lart me postë elektronike drejtuar Projektit në adresën grants_icpp@ewmi.org. Projekti do t’i dërgojë sqarime me postë elektronike të gjitha organizatave të interesuara.

Propozimet: Aplikantët duhet t’i dorëzojnë propozimet e tyre dhe dokumentacionin e kërkuar me postë elektronike Projektit në adresën grants_icpp@ewmi.org. Posta elektronike **duhet** t’i referohet “RFA-JAG-2017-005” në hapësirën e lëndës. Gjithashtu, aplikimet mund të dorëzohen gjatë orarit të punës dhe në një zarf të mbyllur në adresën:

USAID Justice for All

Rr. Skënderbej, Pallati nr. 8, Shkalla 2, Apart. 823

Tiranë, Shqipëri

Aplikimet e dërguara me fax nuk pranohen.

Aplikimet nuk do të pranohen më vonë se ora 17:00 me orën e Tiranës më **10 prill 2017**. Aplikimet e dorëzuara me vonesë ose për të cilat nuk merret përgjigje nuk do të merren në konsideratë.

Propozimet e dorëzuara duhet të jenë punë origjinale dhe vetjake e organizatës(ave) aplikuese. Plagjiatura rezulton në skualifikim nga konkurimi për grante.

Projekti do të ruajë të gjithë materialet dhe dokumentacionin e dorëzuar nga aplikantët. Ky informacion nuk do të përdoret për qëllimet të tjera përveç vlerësimit të propozimit dhe nuk do të ndahet me persona apo institucione të tjera, përveç rasteve kur kërkohet nga legjislacioni shqiptar ose nga USAID.

Ju lutemi, të vini re se, në përputhje me përpjekjet tona për bashkërendimin e donatorëve, ne do të ndajmë emrat e aplikantëve dhe një përshkrim të shkurtër të projekteve të tyre përkatëse me programe të tjera shqiptare dhe ndërkombëtare që mbështesin OSHC-të në Shqipëri.

IX. LISTA E SHTOJCAVE

Lista e mëposhtme e shtojcave është pjesë përbërëse e kësaj Ftese për Aplikime:

Shtojca A – Formulari i Aplikimit për Grant

Shtojca B – Veprimtaritë e Projektit

Shtojca C – Afatet e Zbatimit të Projektit

Shtojca D – Udhëzimet e Buxhetit të Projektit

Shtojca E – Model i Buxhetit të Projektit

Ky program granti mundësohet nga mbështetja e Popullit Amerikan përmes Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID). Përmbajtja e kësaj Kërkese për Aplikime është nën përgjegjësinë e plotë të East West Management Institute, Inc. dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e USAID apo të Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.